

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6509  
E enjte, 13 janar 2022  
çmimi 0.40 €

**KMDLNj: Shtrenjtimi  
i rrymës hap rrugë  
për destabilizim social  
në Kosovë** | FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## PARALAJMËRIMI I IKSHPK-SË: SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE MUND TË PËRKEQËSOHET

 | FAQE 7

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka paralajmëruar të mërkurën se situata epidemiologjike me Covid-19 mund të përkeqësohet në vendin tonë veçmas me shfaqjen e variantit të ri të virusit Omicron. IKShPK ka bërë thirrje për vaksinim në mënyrë që të mbrohemi nga ky virus

### AKTUALE



**BQK-ja MBËSHTET MMPHI-në  
PËR VENDOSJEN E NGJITËSVE  
NË MJETET MOTORIKE** F. 3

**BANKAT NË KOSOVË FITOJNË  
MILIONA EURO NGA TARIFAT  
E SHËRBIMEVE** F. 5

**NATO-ja REFUZON KRAHASIMIN  
E NDËRHYRJES NË KOSOVË  
ME SITUATËN NË UKRAINË** F. 2

### EKONOMI



**QEVERIA MIRATON VENDIMIN PËR  
RRITJEN E PENSIONEVE** F. 8

**PUNËTORËT DENONCOJNË  
PUNËDHËNËSIT E TYRE NË ATK,  
88 RASTE PËR 12 DITË** F. 8

### SPORT



**KLUBI I GJMNASTIKËS 'ELITA' FITON  
KUPËN E KOSOVËS NË GJMNASTIKË  
ARTISTIKE PËR FEMRA** F. 10

## Qeveria miraton Projektligjin për Pronën Publike

 | FAQE 6

**HARADINAJ THOTË SE SPECIALJA  
DUHET TA NDRYSHOJË QASJEN**

| FAQE 4-5

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## NATO-ja refuzon krahasimin e ndërhyrjes në Kosovë me situatën në Ukrainë

**BRUKSEL, 12 JANAR** - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka hedhur poshtë krahasimet midis ndërhyrjes së kësaj aleance në Kosovë më 1999 dhe situatës aktuale në Ukrainë. "Është ide e gabuar se shpërbërja e ish-Jugosllavisë nisi me ndërhyrjen e NATO-s. NATO atje ndërhyri për t'i ndaluar krimet në Kosovë. Në atë kohë Jugosllavia veçse ishte shpërbërë", tha Stoltenberg kur u pyet nga gazetarët në Bruksel nëse ndërhyrja e Aleancës më 1999, pa rezolutë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, shkaktoi shpërbërjen e Jugosllavisë. Sulmet ajrore të NATO-s mbi caqet ushtarake nisën më 24 mars të vitit 1999 dhe zgjatën për 78 ditë. Kjo ndërhyrje i dha fund luftës në Kosovë. Këto komente Stoltenbergu i bëri pas një takimi që shtetet anëtare të NATO-s zhvilluan në Bruksel me zyrtarët rusë, pas tensionimit të situatës në Ukrainë. Moskë ka dërguar rreth 100 000

trupa në kufi me Ukrainën që nga Perëndimi po shihet si përgatitje për një pushtim të mundshëm të Ukrainës. Rusia po kërkon garanci që NATO ta ndalë zgjerimin nga Lindja si dhe t'i tërheqë trupat nga shtetet lindore që kufizohen me Rusinë. Duke folur për këto kërkesa të Rusisë, Stoltenbergu tha se "NATO, sipas artikullit 5, parimit se sulmi ndaj një shteti anëtar është sulm ndaj të gjithëve, do të mbrojë secilin shtet anëtar". NATO përsëriti qëndrimin se secili shtet sovran ka të drejtën që të zgjedhë vetë nëse dëshiron të anëtarësohet në këtë aleancë ushtarake teksa Moskë po insiston që Ukraina të mos bëhet pjesë e kësaj aleance, duke e cilësuar një gjë të tillë si "vijë të kuqe". Në pyetjet nëse me dërgimin e armatimit në Ukrainë ndihmon në uljen e tensioneve, Stoltenbergu hodhi përgjegjësinë te Rusia për përshkallëzimin e situatës.



"Ukraina është një shtet sovran dhe ka të drejtë të mbrohet. Rusia është ndër fuqitë më të mëdha në Evropë, fuqi bërthamore. Ajo tashmë e ka përdorur forcën ushtarake kundër Ukrainës dhe ka okupuar dhe aneksuar territor

të Ukrainës. Të fajësosh Ukrainën është përmbyseje e plotë e të vërtetës dhe gjërave. Rusia është ajo e cila edhe sot kërcënon duke grumbulluar forcat në kufi me Ukrainën. Prandaj është e rëndësishme që Rusia t'i ulë tensionet. Disa

shtete të NATO-s duan ta ndihmojnë Ukrainën që ajo ta realizojë të drejtën e saj për vetëmbrojtje", tha Stoltenbergu. NATO i ka cilësuar si "serioze dhe të drejtpërdrejta" bisedimet që zhvilloi në Bruksel me zyrtarët rusë.

## Gjermania dhe Bullgaria regjistrojnë rekord rastesh me koronavirus



**BERLIN, 12 JANAR** - Gjermania dhe Bullgaria kanë regjistruar shifra rekorde të infektimit me koronavirus, ndërkohë që Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka paralajmëruar për një valë të përhapjes së madhe të variantit Omicron në gjithë kontinentin evropian. Autoritetet gjermane kanë raportuar më 12 janar për 80 430 raste të reja me koronavirus - njëherësh rekord ditor që prej shpërthimit të pandemisë. Shifra totale e rasteve të infektimit në Gjermani tani ka

arritur në 7 661 811. Më 12 janar është raportuar për 384 raste të vdekjes, dhe totali i viktimave tani është 114 735. Të dhënat e Institutit "Robert Koch" në Gjermani tregojnë se rreth 75 për qind e popullsisë prej 83 milionë banorëve, ka të paktën një dozë të vaksinës kundër koronavirusit. Në Evropën juglindore, Bullgaria ka shënuar një rekord prej 7 062 rastesh të reja më 12 janar. Numri i të infektuarve është rritur në javët e fundit dhe ka tejkaluar pikun e tetorit të vitit të kaluar. Bullgaria përbën shtetin me

popullatën më pak të vaksinuar kundër koronavirusit në Bashkimin Evropian. Sipas autoriteteve të këtij shteti, rreth 28 për qind e popullsisë me 6.9 milionë banorë, është vaksinuar plotësisht. Në 24 orët e fundit në Bullgari janë regjistruar 89 vdekje të tjera dhe shifra totale e viktimave ka shkuar në 31 761. Qeveria e re në këtë shtet u ka bërë thirrje të gjithë personave të pavaksinuar që të imunizohen, madje ka ofruar edhe shpërblim prej 44 dollarësh për pensionistët që marrin dozën përforcuese.

## "Pfizer": Doza përforcuese mund të jepet së bashku me vaksinën kundër pneumonisë

Nju-Jork, 12 janar - Kompania farmaceutike "Pfizer" dha se dozat e saj përforcuese kundër Covid-19 mund të administrohen së bashku me vaksinën kundër pneumonisë, dhe ky kombinim vaksinash, sipas kësaj kompanie, prodhon një përgjigje më të fortë dhe më të sigurt imunitare.

"Pfizer" tha se këto të dhëna dalin te studimet e kryera te personat mbi 65 vjeç dhe se studimi është në fazën e fundit. Në studimin që nisi në muajin maj, kompania ka testuar vaksinën e gjeneratës së ardhshme pneumokokale të quajtur Prevnar 20 dhe 570 pjesëmarrësit në studim e

kanë marrë këtë vaksinë së bashku me dozën përforcuese të vaksinës "Pfizer/BioNTech" kundër koronavirusit. Qëllimi i studimit ishte që të testohet siguria e këtij kombinimi dhe përgjigja imunitare, duke shtuar vaksinën kundër pneumonisë dhe vaksinës ekzistuese kundër Covid-19.



# BQK-ja mbështet MMPHI-në për vendosjen e ngjitësve në mjetet motorike

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 JANAR - Në zyrat e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) është mbajtur të mërkurën takim ndërmjet guvernatorit Fehmi Mehmeti dhe zëvendësguvernatorit Sokol Havolli me zëvendësministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi, përfaqësuesit e Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), Besarb Blakaj, kryetar i Këshillit Administrativ dhe Sami Mazreku, drejtor ekzekutiv, ku është diskutuar lidhur me iniciimin e projektit për vendosjen e ngjitësve (stickers) nëpër mjetet motorike me qëllim të identifikimit më të lehtë nëse këto mjete motorike qarkullojnë si të regjistruara ligjërisht ose jo.

BQK-ja dhe BKS-ja përkrahin Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për vendosjen e ngjitësve (stickers) nëpër mjetet motorike. Të gjitha shpenzimet financiare dhe operative lidhur me vendosjen e ngjitësve nëpër mjete motorike do ta bartin siguruesit, respektivisht BKS-ja si përfaqësuese e industrisë së sigurimeve në Kosovë.

Rrjedhimisht, buxheti i shtetit të Republikës së Kosovës nuk do të



ketë asnjë ngarkesë financiare lidhur me vendosjen e ngjitësve (stickers).

Duke filluar nga data 1 mars 2022 është planifikuar të fillojë zbatimi i plotë i projektit ashtu që brenda periudhës prej një viti të kemi një gjendje të re mbi automjetet e regjistruara rregullisht në Republikën e Kosovës. Nga kjo datë e tutje, anëtarët sigurues të BKS-së do ta kenë autorizimin për vendosjen e ngjitësve (stickers)

nëpër mjetet motorike, me rastin e sigurimit të tyre pranë Qendrave të Regjistrimit të Automjeteve.


Për implementimin e plotë të këtij projekti, lidhur me vendosjen e ngjitësve (stickers) në mjetet motorike për identifikimin e të njëjtave nëse ato qarkullojnë në komunikacionin rrugor të regjistruara ligjërisht ose jo, do të nënshkruhet memorandum i mirëkuptimit me kohëzgjatje prej një viti, për monitorimin e zbatimit

të të njëjtit. Zëvendësministri Durmishi u zotua se në kuadër të këtij memorandumit të mirëkuptimit, Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i nxjerrë të gjitha aktet e nevojshme nënligjore për ta zbatuar plotësisht projektin në fjalë. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës, në kuadër të kompetencave ligjore që kanë sipas ligjit, do ta verifikojnë rregullsinë e dokumentacionit përkatës të mjeteve motorike në qarkullim

rrugor.

Implementimi i këtij projekti për vendosjen e ngjitësve (stickers) nëpër mjetet motorike ka për qëllim uljen e numrit të mjeteve motorike të pasiguruara/paregjistruara në qarkullim rrugor, si një ndër parakushtet e domosdoshme për anëtarësim në organizatën e Këshillit të Byrove në Bruksel ose gjetjen e zgjidhjeve alternative për qarkullim të lirë.

## Handikos-i ofroi mbi 800 pajisje ndihmëse për qytetarët në nevojë në vitin 2021



PRISHTINË, 12 JANAR- Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës - Handikos përgjatë vitit 2021 me përkushtim ofroi shërbimin e pajisjeve ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara dhe gjithë qytetarët e Kosovës në nevojë.

Vetëm përgjatë vitit që lamë pas, nga depot e Qendrës së Resurseve të Handikos në Prishtinë janë ofruar mbi 800 pajisje të ndryshme që shërbejnë për lëvizje të lirë, mes tyre karroca, paterica, shëtitore, shtretër ortopedikë etj. Ndërkaq 180 persona ishin përfitues të materialeve për inkontinencë.

Vlen të theksohet, se vetëm prej karrocave, janë ofruar rreth 500

sosh, të reja dhe të përdorura. Ndërkohë, udhëzime, informacione dhe këshilla rreth mirëmbajtjes apo çështjeve teknike të tyre ishin rreth 5 000 të tilla përmes linjave mobile.

Përveç shërbimit me pajisje ndihmëse, Handikos ka ofruar edhe shërbime direkte me fëmijë dhe të rritur, shërbime të këshillave ligjore, vizita në terren etj. Ndërsa përgjatë vitit, janë dhuruar 350 pako ushqimore dhe higjienike për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre.

Handikos-i, bazuar në misionin dhe vizionin e saj, por edhe në kuadër të implementimit të projekteve do të vazhdojë të shërbejë çdoherë për personat me aftësi të kufizuara, dhe jo vetëm.

## Latifi nënshkruan vendimin për caktimin e këshillit organizues të Ditëve Përkujtimore "Flaka e janarit"

RAHOVEC, 12 JANAR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka nënshkruar vendimin për caktimin e këshillit organizues të Ditëve Përkujtimore "Flaka e janarit". Përbërja e këtij këshilli është kjo: Afrim Dina, kryesues; Avni Morina, anëtar; Nora

Boshnjaku, anëtare; Feriz Thaçi (përfaqësues nga OVL e UÇK-së), anëtar; Dervish Çadraku, anëtar; Blerta Gashi, anëtare; Shadat Ukaj, anëtar; Qemajl Krasniqi, anëtar; Qëndresa Duraku, anëtare; Naser Dula, anëtar dhe Muharrem Morina, anëtar.

Pika 1 e vendimit thotë se këshilli organizues "Flaka e janarit" ka për detyrë t'i shpërndajë ftesat për grupe dhe individë të rëndësishëm, të japë çmime, ta caktoj datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohen aktivitetet, të ndërmarë të gjitha veprimet

organizative për mbarëvajtjen e Ditëve Përkujtimore. Ndërsa pika 2 e vendimit thotë se organizimi dhe ndarja e përgjegjësi për pjesën operative të Ditëve Përkujtimore "Flaka e janarit" i takon kryesuesit të këshillit organizues.



**"FLAKA E JANARIT 2022"**  
**MË 21, 27 DHE 29 JANAR**



NASIM HARADINAJ KA VAZHDUAR DËSHMINË NË GJYKATËN SPECIALE

## Haradinaj thotë se Specialja duhet ta ndryshojë qasjen

Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Nasim Haradinaj, ka kërkuar nga Gjykata Speciale që ta ndryshojë qasjen e saj ndaj krimeve të luftës në Kosovë. Në ditën e dytë të dëshmisë, në procesin që po zhvillohet ndaj tij, Haradinaj ka thënë se Dhomat e Specializuar duhet të merren me të gjitha krimet e luftës në Kosovë. Ai ka bërë me dije se nëse kjo gjykatë heton vetëm shqiptarët atëherë do të vazhdojë të jetë kundër kësaj gjykate. I emocionuar, ai ka përmendur krimet serbe në Kosovë dhe bashkëpunëtorët e Speciales

kryera, pavarësisht se kush i ka kryer ato. Këtë po e them për të qenë të qartë se ne nuk po kërkonim shfuqizimin apo mbylljen e Dhomave të Specializuara. Ne kemi kërkuar një amendamentim për ta futur, pra për këtë çfarë e thash më lartë. Të gjitha krimet. Dhe nëse kjo prokurori e pranon se nuk po dëshiron që t'i ndjek të gjitha krimet, unë po të them edhe njëherë ne nuk po mundemi ta shfuqizojmë sepse ju jeni shtet paralel. Kosova e ngratë veç rinë, sepse i tregojnë përralla shoqi-shoqit ata deputetë që kanë çuar gishtin", ka thënë Haradinaj.

Ai ka deklaruar se vazhdon të mbetet pro shfuqizimit të kësaj gjykate, derisa ajo të jetë njëjetnike. Sipas tij, shqiptarët e Kosovës nuk kanë të bëjnë me krime të luftës. "Po dëshiron ti që të më detyrosh të dalë kundër të drejtave të popullit tim", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se është kundër atyre që

duan ta përlejnë luftën dhe shtetin e tij, Republikën e Kosovës.

Në dëshminë e tij, Haradinaj ka kritikuar edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës, të cilët e kanë themeluar Gjykatën Speciale.

Sipas tij, ata kanë mundësuar që kjo gjykatë ta kapë drejtësinë e sistemit të Kosovës. "82 parlamentarë e kanë çuar gishtin pa e ditur se çka po bëjnë. Fajin e kanë deputetët e Kosovës që ta kanë mundësuar ty zotëri prokuror t'i uzurposh kompetencat edhe të Gjykatës Kushtetuese, edhe të Avokatit të Popullit, por edhe të drejtësisë. Nuk pyetet askush më në Kosovë", ka deklaruar Haradinaj. Ai ka treguar se kush janë bashkëpunëtorët e Gjykatës Speciale. "Prokuroria shpesh fjalët po i spekulon. Ose duhet ta pranojë se nuk dinë. E di krejt bota se kush janë spiunët. Ata janë bashkëpunëtorët e regjimit komunist", është shprehur ai. Nga prokurori, përveç çështjes

së dosjeve, ai është pyetur edhe nëse mendon që UÇK-ja mund të ketë kryer krime derisa Haradinaj ka thënë se Ushtria Çlirimtare të Kosovës, dhe ai si pjesë e saj, gjatë luftës në Kosovë nuk kanë synuar civilët, por vetëm kanë mbrojtur vendin dhe janë përballur me ushtrinë serbe. "Po, kam vrarë ushtarë serbë edhe oficerë, që ata thonë që është oficer se unë nuk e kam ditë çka ka qenë, po nuk ka këtu të bëjë me civil asnjë gjë, unë nuk jam kthyer nga Suedia edhe për të dhënë lule, derisa jam kthyer të hyj në front. Kam pranuar të vdes vet. Unë kam qenë në front, po flas për pikën e frontit, nuk jam marrë me civilë, as nuk jam marrë pas luftës me më këto sende. Është çliruar vendi im dhe në rregull është. Jam plagosur prej tyre, që kam mundur të jem edhe i vrarë, dhe nuk po lyp askush llogari pse më kanë plagosur. Në rastin tim as nuk po lyp llogari pse më kanë plagosur, as nuk po jap llogari pse kam gjuajtur në ta derisa

**EPOKA  
ERE**

Muhamet KOCI

**PRISHTINË, 12 JANAR**- Intervistimi i nënkryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Nasim Haradinaj, ka vazhduar edhe të mërkurën në Dhomat e Specializuara në Hagë.

Në ditën e dytë të dëshmisë së tij në Hagë, duke u përgjigjur në

pyetjet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, ai ka kritikuar Gjykatën Speciale duke e cilësuar të njëanshme dhe të padrejtë.

Ai nuk ka hequr dorë nga pretendimi i tij për ta zhbërë këtë gjykatë, nëse ajo vazhdon të jetë selektive në trajtimin e krimeve të luftës. "Ne kemi kërkuar futjen e një amendamenti që parashikonte hetimet për të gjitha krimet e

# Bankat në Kosovë fitojnë miliona euro nga tarifat e shërbimeve

PRISHTINË, 12 JANAR - Mbi 74 milionë euro llogaritet vlera e të hyrave vetëm nga tarifat e shërbimeve dhe komisioneve në 11 bankat komerciale që operojnë në Kosovë. "Vlera e të hyrave të bankave nga jointeressi deri në muajin nëntor të vitit 2021, ishte 78.3 milionë euro. Nga kjo shumë, 74.4 milionë euro

janë të hyra nga tarifat dhe komisionet, dhe 3.9 milionë nga të ardhurat tjera operative", thuhet në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë" nga zyrtarë të Bankës Qendrore të Kosovës.

Disa nga institucionet financiare në Kosovë kanë paralajmëruar klientët e tyre për rritje të

çmimeve të tarifave për shërbime. Në këto shërbime përfshihen mirëmbajtja e llogarisë, tërheqja e parave, transferet, pagesat e faturave dhe shërbime të tjera.

Bankat komerciale, tarifat për shërbime i aplikojnë në bazë të politikave të brendshme, pasi BQK-ja nuk aprovon çmimoren e bankave. "Sipas Rregullores për

normën efektive dhe kërkesat për shpalesje, kërkohet nga bankat që çdo tarifë që e aplikojnë, ta ndërlidhin me koston përkatëse. Megjithatë, bazuar në trendet e bankut digjital, aplikimi i tyre mund të ketë kosto të mirëmbajtjes së sistemeve, por që në fund bankat janë ato që specifikojnë çmimoret e

produkteve në bazë të politikave dhe procedurave të brendshme", thuhet në përgjigjen e BQK-së.

Rritja e tarifave për shërbime vjen në kohën kur Kosova e përmbylli vitin 2021 me rritjen më të lartë të çmimeve të produkteve ushqimore dhe paralajmërimeve për shtrenjtim të faturave të energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm.



kam qenë i sulmuar, në vetëmbrojtje kam qenë, në vendin tim më kanë sulmuar", ka thënë ai.

Haradinaj ka folur edhe për momentin e arrestimit, derisa po shkonte për një intervistë në një televizion. "Gjatë kohës kur kam shkuar për intervistë e kam parë një veturë të EULEX-it që ka qenë pranë taksit kur unë kam qenë, e mendova që jam duke u përcjellë. Nja 50 metra më poshtë ka dalë nga krahu i djathtë i yni një xhip i madh i EULEX-it. Kish qenë i parkuar brenda një rrugice dhe na erdhi nga mbrapa. Më vonë e pashë që nuk lejonin vetura që të na hynin në mes. E pashë që janë në përcjellje. Asgjë tjetër. I thashë jep sinjal për t'u kthyer në krahu e majtë por mos u kthe se kemi për të shkuar në T7. Kur dha ai sinjal ka dhënë menjëherë edhe xhipi që e kishim prapa. Aty e dita që janë duke na përcjell dhe i thashë taksistit vazhdo se qita janë pas nesh", ka thënë ai.

Nënkryetari i OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj dhe kryetari i kësaj organizate, Hysni Gucati, akuzohen nga Gjykata Speciale për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës. "Akuzat e paraqitura në aktakuzën e konfirmuar mbështeten në dyshimin e bazuar mirë se, së paku, midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, z. Gucati dhe z. Haradinaj zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej Ligjit të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve (të mundshëm), në tri konferenca shtypi dhe aktivitete të tjera të transmetuara, si dhe përmes shpërndarjes së mëtejshme ku përfshihen deklaratat në rrjete sociale", është thënë në njoftimin e Dhomave të Specializuara.



# Qeveria miraton Projektligjin për Pronën Publike



Qeveria e Kosovës ka miratuar të mërkurën Projektligjin për Pronën Publike i cili rregullon të drejtën pronësore publike dhe të drejtat e tjera pasurore të Republikës së Kosovës dhe të njësive të tjera të vetëqeverisjes lokale, duke përcaktuar edhe të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre subjekteve. Projektligji përkufizon pronën publike, si dhe përcakton formën e deponimit dhe të shfrytëzimit të kësaj prone

**EPOKA E RE** **Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 12 JANAR** - Një projektligj, një konceptdokument dhe shtatë vendime të ndryshme nga fusha e përgjegjësisë kushtetuese dhe ligjore u miratuan në mbledhjen e 54-t të qeverisë, të parën për këtë vit. Në hapje të mbledhjes, kryeministri Albin Kurti ka shprehur keqardhjen për aksidentin e autobusit me udhëtarë nga Kosova, në vendin Kupci i Madh, afër Krushevcit, në Serbi. "Sipas informatave, fatmirësisht të gjithë udhëtarët e lënduar janë jashtë rrezikut për jetë. Është koha e kthimit të mërgatës sonë në vendet ku ata jetojnë dhe punojnë. Shpirtërisht jemi me ta, derisa ata kalojnë mijëra kilometra në këto kohë të

acarta të dimrit. Sakrifica, kontributi, munda i tyre për të qëndruar sa më afër familjarëve në Kosovë, është për t'u admiruar. Urojmë që udhëtimet e tyre të jenë sa më të lehta e të sigurta dhe, edhe një herë, ju urojmë shërim të shpejtë dhe të plotë të gjithë të lënduarve. Institucionet e Republikës së Kosovës janë në kontakt të vazhdueshëm dhe do të bëjnë gjithçka dhe çdo gjë që është e mundur për t'i ndihmuar të prekurit nga ky aksident", ka thënë Kurti.

Në vazhdim të mbledhjes u miratua Projektligji për Pronën Publike i cili rregullon të drejtën pronësore publike dhe të drejtat e tjera pasurore të Republikës së Kosovës dhe të njësive të tjera të vetëqeverisjes lokale, duke përcaktuar edhe të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre

subjekteve. Projektligji përkufizon pronën publike si dhe përcakton formën e deponimit dhe të shfrytëzimit të kësaj prone.

Miratimin e qeverisë në këtë mbledhje e ka marrë edhe plotësimi dhe ndryshimi i vendimit të qeverisë për themelimin e komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare në Kosovë. Me ndryshimet e miratuara Leonora Selmani emërohet kryesuese e këtij komisioni, ndërsa Minire Begaj, kryesuese e deritashme, emërohet anëtare e këtij komisioni. Po ashtu, qeveria ka emëruar komisionin e përzgjedhjes për rekomandim të kandidatëve për kryetarë dhe të katër anëtarëve të bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik. Alban Nevzati, kryesues, Leonita Shabani-Mullarama, anëtare, Isuf Zejna, anëtar, Enis Spahiu, anëtar, dhe Imer Shevelli, anëtar.

Në këtë mbledhje të kabinetit qeveritar u miratua edhe vendimi për themelimin e 'Njësies për Ekspertizë' në kuadër të Sekretariatit Koordinues të Qeverisë të Zyrës së Kryeministrit, si strukturë përgjegjëse qeveritare me qëllim të mbështetjes së institucioneve në fusha specifike dhe deficitare përmes angazhimit të ekspertëve vendorë dhe të huaj.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të 'Njësies për Ekspertizë' do të jenë për identifikimin e nevojave të institucioneve publike për ekspertizë dhe të tregut të ekspertëve brenda dhe jashtë vendit; administrimin e procesit të angazhimit të ekspertëve me qëllim të përmbushjes së kërkesës për ekspertizë përmes ofertës së tregut; dhe përgjegjësi të tjera, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe nga menaxhmenti i ZKM-së.

Me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë është miratuar vendimi për pagesën e specializantëve me vetëfinansim, prej datës 01.01.2022 deri më 31.08.2022. Po ashtu, është themeluar Këshilli Kombëtar për Ndryshimet Klimatike në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili është përgjegjës për përcjelljen dhe zbatimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit për ndryshimet klimatike në përputhje me angazhimet në kuadër të Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, Marrëveshjes së Parisit dhe Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor.

Këshilli përbëhet nga ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe të Infrastrukturës, që do ta kryesojë Këshillin; ministri i

Ekonomisë; ministri i Financave, Punës dhe Transfereve; ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; ministri i Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal; dhe ministri i Shëndetësisë.

Vendimi për shqyrtim të mëtejme të shpronësimit për interes publik është miratuar në këtë mbledhje. Ky vendim aprovon shqyrtimin e mëtejme të shpronësimit për interes publik të pronave të paluajtshme shoqërore të Ndërmarrjes Shoqërore "OPB Mirusha" të cilat preken nga realizimi i projektit për ndërtimin e objektit të Qendrës për Pajisje me Dokumente dhe të Qendrës për Regjistrimin e automjeteve në Malishevë.

Ka marrë miratimin edhe konceptdokumenti për Agjencinë e Mbrojtjes për Inteligjencë dhe Siguri në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Koncept-dokumenti rekomandon që të rregullohet ligjërisht mbledhja dhe përpunimi i informacioneve të rëndësishme për sigurinë e pjesëtarëve të Forcave të Sigurisë së Kosovës, mbrojtje të sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës. Kjo do të jetë edhe një vlerë e shtuar për Forcën e Sigurisë së Kosovës për përmbushjen e mandatit dhe misionit të saj.

## Shpallet konkursi për Kryeprokuror të Shtetit

**PRISHTINË, 12 JANAR** - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga kryesuesi Jetish Maloku, ka mbajtur takimin e radhës. Anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës kanë marrë vendim në fillim të këtij takimi për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit.

Ky vendim është marrë duke u bazuar në Rregulloren nr. 06/2019 për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive

të Republikës së Kosovës e cila përcakton që konkursi shpallet së paku 90 ditë para skadimit të mandatit të Kryeprokurorit aktual të Shtetit.

Mandati shtatëvjeçar i Kryeprokurorit aktual të Shtetit, Aleksandër Lumezi, do të përfundojë më 21 prill 2022. KPK-ja ka themeluar edhe panelin vlerësues për poentimin e kandidatëve që aplikojnë për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit. Anëtarë të këtij paneli, përveç

kryesuesit të Këshillit, Jetish Maloku, që, sipas detyrës zyrtare, është anëtar dhe kryesues i panelit, përmes shortit u përzgjedhën edhe anëtarët e KPK-së, Ariana Shajkovi, Bedrije Sylja-Alshiqi, Armend Zenelaj dhe Jovo Radović.

Ndërsa anëtarë të Komisionit për rishqyrtim të kundërshtimeve të kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit, pas tërheqjes së shortit, u përzgjedhën anëtarët e KPK-së,



Veton Shabani, Ardian Hajdaraj dhe Agron Beka. Konkursi për Kryeprokuror të

Shtetit do të shpallet më 17 janar dhe do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes.

# Paralajmërimi i IKShPK-së: Situata epidemiologjike mund të përkeqësohet

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka paralajmëruar të mërkurën se situata epidemiologjike me Covid-19 mund të përkeqësohet në vendin tonë veçmas me shfaqjen e variantit të ri të virusit Omicron. IKShPK ka bërë thirrje për vaksinim në mënyrë që të mbrohemi nga ky virus

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 JANAR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se nga fillimi i vitit ka filluar rritja e rasteve pozitive me Covid-19, veçmas me shfaqjen e variantit të ri të virusit Omicron. IKShPK-ja ka njoftuar se situata epidemiologjike mund të përkeqësohet edhe më shumë ditët në vazhdim. Ky institut ka apeluar te qytetarët që të respektohen masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës. "Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të përhapjes së Covid-19 bëjmë thirrje për kujdes dhe mosgrumbullim. U rekomandojmë institucioneve përgjegjëse ta mbikëqyrin me përpikëri dhe t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për parandalimin dhe luftimin e pandemisë. Është i

domosdoshëm kujdesi i shtuar i të gjithëve që në mënyrë strikte të respektohet distanca fizike, të përdoren maskat, të bëhet dezinfektimi dhe ajrosja e hapësirave, duke pamundësuar dhe shmangur përhapjen eventuale të mëtejme të infeksionit të Covid-19. Omicron është tejet ngjitës, andaj mbani maskat në çdo vend, mbani distancën mbi dy metra edhe në mjedise të hapura edhe po qe se të gjithë bartin maska", ka njoftuar IKShPK-ja.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka theksuar se duke qenë se vaksinimi është mënyra më e mirë dhe më e sigurt për të parandaluar Covid-19, veçanërisht format e rënda të sëmundjes dhe vdekjet, bën thirrje për vaksinim sa më gjithëpërfshirës dhe sa më të shpejtë të popullatës nga mosha 12-vjeçare. "Vaksinat mund të merren çdo ditë në të gjitha institucionet e kujdesit parësor

në komunën tuaj. Gjithashtu, apelojmë për vaksinimin me dozën përforcuese dhe dozën e tretë që mund ta marrin të gjithë qytetarët e moshës mbi 18-vjeçare. Vaksinohuni dhe ftoni të tjerët të vaksinohen", është thënë në apelin e IKShPK-së. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të mërkurën se prej 6 360 testeve, 424 qytetarë kanë

rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar një rast i vdekjes.

Më 12 janar janë shënuar 89 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 158 284. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 2 417.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 3

189 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 701 091 doza të vaksinës. Deri më sot 792 605 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Deri më sot janë dhënë 22 871 doza përforcuese dhe 2 127 doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.

## Nënshkruhet marrëveshja për vizitat mjekësore në shtëpi



PRISHTINË, 12 JANAR - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi dhe shefja e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Nona Zicherman, kanë nënshkruar të mërkurën marrëveshjen e bashkëpunimit për planin e vizitave mjekësore në shtëpi.

Programi i vizitave në shtëpi për shëndetin dhe mirëqenien e nënës dhe fëmijës ka filluar të zbatohet në Kosovë në vitin 2014. Aktualisht ky program është i integruar në sistemin e Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe zbatohet në 22 komuna të vendit. Programi i vizitave në shtëpi ka për qëllim përmirësimin e qasjes në shërbime të Kujdesit Parësor Shëndetësor për gratë shtatzëna, fëmijët nën tre vjeç dhe prindërit e tyre, veçanërisht për familjet e cenushme.

Ministri Latifi dhe Zicherman vlerësuan se objektiv është zgjerimi i këtij programi në të gjitha komunat e Kosovës me qëllim që përmes mjekëve dhe infermierëve të trajnuar të ofrohen shërbime shëndetësore të integruara dhe gjithëpërfshirëse për fëmijët dhe gratë shtatzëna gjatë vizitave mjekësore në shtëpi, ndërkohë që u pajtuan t'i zgjerojnë mundësitë e bashkëpunimit edhe në projekte të tjera në dobi të të gjitha komuniteteve në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Programi i vizitave mjekësore në shtëpi zbatohet nga MSh dhe Kujdesi Parësor Shëndetësor, me përkrahjen e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, përmes fondeve të Qeverisë së Luksemburgut.

## Totaj kërkon angazhim në punë nga drejtorët komunalë

PRIZREN, 12 JANAR - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka mbajtur takimin e parë me kabinetin e drejtorëve komunalë, të cilët i ka

informuar për proceset të cilat i presin ata në ditët në vazhdim. "Nga drejtorët e kabinetit kërkova të fillojnë punën që sot, me përgjegjësi për interesin e

përgjithshëm publik, me transparencë në të gjitha proceset e punës, të ndërtojnë ura komunikimi me të gjithë aktorët relevantë,

bashkëpunim mes drejtorive dhe efektivitet në proceset që duhen shtyrë dhe punët që na presin", ka thënë pas takimit kryetari Totaj.



## Punëtorët denoncojnë punëdhënësit e tyre në ATK, 88 raste për 12 ditë

PRISHTINË, 12 JANAR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se brenda 12 ditëve janë raportuar 88 raste denoncuese përmes aplikacionit elektronik për verifikimin e punëtorëve nëse janë të deklaruar/regjistruar nga punëdhënësit e tyre. Sipas

njoftimit, bazuar në projektin për formalizimin e punësimit, ndër arsyt kryesore që kanë kontribuar që punësimi joformal të trajtohet si i tillë janë nëndeklarimi i pagave, pagesa e pagave në dorë, të punësuarit pa kontrata pune etj. "Të gjitha pikat e përmendura janë evidentuar edhe në raportet

dhe anketat e bëra nga Banka Botërore, raportet e financuara nga Bashkimi Evropian, Agjencia e Statistikave e Kosovës, Akademia e Shkencave e Kosovës, Njësia e Inteligjencës Financiare, si dhe nga institucionet e tjera dhe të gjeturat nga ATK-ja në terren", ka njoftuar ATK-ja.



## KMDLNj: Shtrenjtimi i rrymës hap rrugë për destabilizim social në Kosovë

**EPOKA E RE**

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 JANAR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) përmes një reagimi për medie ka theksuar se shtrenjtimi i rrymës hap rrugë për destabilizim social në Kosovë. "KEDS-i është shumë insistues ndaj ZRRE-së që ta miratojë kërkesën për rritje të faturave për energji elektrike në shumën 30-40 për qind, si hap i parë drejt rritjes së radhës së çmimit të rrymës e që jetën e shumicës së

qytetarëve të Kosovës do ta bëjë të pamundur shkaku se edhe me çmimet e tashme kanë shumë probleme t'i shlyejnë faturat", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

KMDLNj ka theksuar se rritja e faturave për rrymën e shpenzuar shkakton një rritje zinxhirore të gjithë artikujve të tjerë. "Rritja e faturave për rrymën e shpenzuar shkakton një rritje zinxhirore të të gjithë artikujve të tjerë si dhe thuaja të të gjitha shërbimeve duke vështirësuar deri në rrezikim të mbijetesës gjendjen e kategorive

të rrezikuara ku pensionistët e të gjitha kategorive përbëjnë grupin më të cenueshëm, shkaku i moshës, gjendjes shëndetësore si dhe pensioneve që edhe me rritjen e fundit nuk e kalojnë cakun e një intervenimi social, dhe jo një pension që i përmbush nevojat elementare dhe që respekton kontributin e kësaj kategorie të shoqërisë kosovare gjatë jetës dhe punës së tyre. Nëse Qeveria e Kosovës nuk ka një plan konkret për subvencionim të kategorisë së marginalizuar atëherë, duke socializuar humbjet e KEDS-it

dhe duke ua trashur lëngun ZRRE-së, këtë kategori do ta dërgojë drejt afrikanizimit social dhe ekonomik, duke kontribuar në rënimin e shëndetit dhe rrezikimit të jetës e që është në kundërshtim të plotë me të gjitha dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut", është thënë në të këtë reagim.

KMDLNj ka vlerësuar se shtrenjtimi i paralajmëruar i energjisë elektrike i krijon të gjitha parakushtet për shprehje të pakënaqësisë qytetare në kërkim të një jete më të

dinjitetshme dhe jo prapakthim siç do të ndodhë nëse Qeveria e Kosovës nuk do t'i rrisë pensionet, por edhe pagat në përputhje me inflacionin dhe rritjen e çmimeve të shportës së shpenzimeve për një familje.

KMDLNj ia ka kujtuar Qeverisë së Kosovës se është duke u sjell si të gjitha qeveritë paraprake sa i përket trajtimit të pensionistëve kontributpagues të cilët janë larguar dhunshëm nga puna nga regjimi i Serbisë, duke mos ua pranuar stazhin e punës në kohën kur ishin larguar dhunshëm nga vendet e punës.



## Qeveria miraton vendimin për rritjen e pensioneve

PRISHTINË, 12 JANAR - Me kërkesë së Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, sot në mbledhjen e 54-t të qeverisë është miratuar vendimi për rritjen e shumës së skemave pensionale për katër kategori ashtu që asnjë pension të mos jetë nën vlerën prej 100 eurosh.

Kategoritë përfituese nga ky vendim janë pensionet bazike që kishin vlerë prej 90 eurosh, pensionet e aftësive të kufizuara që kishin vlerë prej 75 eurosh, pensionet familjare që kishin vlerë prej 90 eurosh, si dhe pensionet invalide të punës që kishin vlerë prej 90 eurosh. Si rezultat i këtij vendimi, rreth


175 mijë pensionmarrës nga kategoritë e mësipërme do të përfitojnë nga rritja në pensione.

Ky vendim paraqet një hap të rëndësishëm drejt përmbushjes së objektivave nga Programi Qeverisës 2021-2025, veçanërisht për ngritjen e mirëqenies sociale në vend.





# Psikologjia e narcizizmit



## Keith CAMPBELL

Shumë përpara se të shkruhej selfie i parë, grekët dhe romakët e lashtë kishin një mit për dikë që ishte paksa shumë i fiksuar pas imazhit të tij. Sipas rrëfimit, Narcisi ishte një djalë i pashëm që endej nëpër botë në kërkim të dikujt për ta dashuruar. Pasi refuzoi një nimfë të quajtur Echo, ai hodhi sytë mbi reflektimin e vetes në ujën e një lumi dhe ra në dashuri me të. Në pamundësi për t'ia shqitur sytë vetes, Narcisi u mbyt. Një lule mbiu në vendin ku ai vdiq, dhe ne e quajmë atë lule Narcisi.

Kjo legjendë rrok idenë bazë të narcizizmit, vetëpërfshirjes së tepruar dhe ndonjëherë të dëmshme. Por nuk është vetëm një lloj personaliteti që shfaqet në artikujt e këshillave. Në fakt është një grup tiparësh të klasifikuara dhe të studiuara nga psikologët. Përkufizimi psikologjik i narcizizmit është një imazh i fryrë, madhështor mbi veten. Në shkallë të ndryshme, narcizistët mendojnë se duken më mirë, më të zgjuar dhe më të rëndësishëm se njerëzit e tjerë

dhe se meritojnë trajtim të veçantë. Psikologët njohin dy forma të narcizizmit si një tipar personaliteti: narcizizmin madhështor dhe të brishtë. Ekziston edhe çrregullimi i personalitetit narcizist, një formë më ekstreme.

Narcizizmi i madhështisë është lloji më i njohur, i karakterizuar nga ekstroversioni, dominimi dhe kërkimi i vëmendjes. Narcizistët shkojnë pas vëmendjes dhe pushtetit, ndonjëherë si politikanë, të famshëm ose udhëheqës kulturorë. Sigurisht, jo të gjithë ata që ndjekin këto pozicione pushteti janë narcizistë. Shumë e bëjnë këtë për arsye shumë pozitive, si arritja e potencialit të tyre të plotë ose ndihma për të përmirësuar jetën e njerëzve. Por individët narcizistë kërkojnë pushtet, për statusin dhe vëmendjen që e shoqëron atë.

Ndërkohë, narcizistët e brishtë mund të jenë të qetë dhe të rezervuar. Ata kanë një ndjenjë të fortë të së drejtës, por kërcënohen ose nënvlerësohen kollaj.

Në secilin rast, ana e errët e narcizizmit shfaqet në një afat

të gjatë. Narcizistët priren të veprojnë në mënyrë egoiste, kështu që udhëheqësit narcizistë mund të marrin vendime të rrezikshme ose joetike, dhe partnerët narcizistë mund të jenë të pandershëm ose të pabesë. Kur pikëpamja e tyre rozë për veten sfidohet, ata mund të bëhen të zemëruar dhe agresivë. Është si një sëmundje ku të sëmurët ndihen mjaft mirë, por njerëzit rreth tyre vuajnë.

E çuar në ekstrem, kjo sjellje klasifikohet si një çrregullim psikologjik i quajtur çrregullim i personalitetit narcizist. Prek një deri në dy përqind të popullsisë, më shpesh meshkujt. Është gjithashtu një diagnozë e rezervuar për të rriturit. Të rinjtë, veçanërisht fëmijët, mund të jenë shumë të përqendruar te vetja, por kjo mund të jetë thjesht një pjesë normale e zhvillimit. Edicioni i pestë i Manualit Diagnostik dhe Statistikor të Shoqatës Psikiatrike Amerikane përshkruan disa tipare që lidhen me çrregullimin e personalitetit narcizist. Ato përfshijnë një pikëpamje madhështore për veten,


probleme me ndjeshmërinë, ndjenjën e të drejtës dhe nevojën për admirim ose vëmendje. Ajo që i bën këto tipare një çrregullim të vërtetë personaliteti është se ato marrin përsipër jetën e njerëzve dhe shkaktojnë probleme të rëndësishme. Imagjinoni që në vend që të kujdeseni për bashkëshortin ose fëmijët, t'i përdorni ata si burim vëmendjeje ose admirimi. Ose imagjinoni që në vend që të kërkonit reagime konstruktive për performancën tuaj, t'u thoni të gjithëve që u përpoqën t'ju ndihmojnë se e kishin gabim.

Atëherë, çfarë e shkakton narcizizmin? Studimet e shumta flasin për një komponent të fortë gjenetik, megjithëse nuk e dimë se cilat gene janë të përfshira. Por mjedisi gjithashtu ka rëndësi. Prindërit që e vendosin fëmijën e tyre në një pedestal mund të nxisin narcizizmin e madhështisë. Dhe prindërit e ftohtë dhe kontrollues mund të kontribuojnë në narcizizmin e brishtë.

Narcizizmi gjithashtu duket të jetë më i lartë në kulturat që vlerësojnë individualitetin dhe

vetëpromovimin. Në Shtetet e Bashkuara, për shembull, narcizizmi si tipar personaliteti është rritur që nga vitet 1970, kur fokusi bashkësor i viteve '60 i la vendin lëvizjes së vetëvlerësimit dhe rritjes së materializmit. Kohët e fundit, mediat sociale kanë shumëfishuar mundësitë për vetëpromovim, megjithëse vlen të përmendet se nuk ka asnjë provë të qartë që mediat sociale shkaktojnë narcizisëm. Përkundrazi, ajo u ofron narcizistëve një mjet për të kërkuar statusin dhe vëmendjen shoqërore.

Atëherë, a munden t'i përmirësojnë narcizistët këto tipare negative? Po! Çdo gjë që nxit reflektimin e ndershëm mbi sjelljen e tyre dhe kujdesin për të tjerët, si psikoterapia ose praktikimi i dhembshurisë ndaj të tjerëve, mund të jetë e dobishme. Vështirësia është se mund të jetë sfiduese për njerëzit me çrregullim të personalitetit narcizist që të vazhdojnë të punojnë për të përmirësuar veten. Për një narcizist, vetë-reflektimi është i vështirë nga një këndvështrim jo i këndshëm. / TED Talks – Bota.al



QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

## Klubi i Gjmnastikës 'Elita' fiton Kupën e Kosovës në Gjmnastikë Artistike për Femra



PRISHTINË, 12 JANAR - Klubi i Gjmnastikës "ELITA" nga Prishtina është ekipi fitues i Kupës së Kosovës në Gjmnastikën Artistike për Femra. Ky klub ka grumbulluar në total 392.51 pikë, ndërsa fituese e Kupës së Kosovës për Meshkuj është Akademia e Gjmnastikës "Universiteti" që ka grumbulluar 129.99 pikë. Në garat e Kupës së Kosovës të mbajtura më 25 dhjetor

2021 dhe 8 janar 2022, të organizuara nga Federata e Gjmnastikës e Kosovës në Gjmnastikën Artistike për Femra dhe Meshkuj, Klubi "Elita", e përfaqësuar me 12 sportistë, (Olisa, Leona, Bora, Elena, Riana, Una, Vilëza, Jarita, Valëza, Fitore, Lisa, Rizona dhe Genti), ka grumbulluar gjithsej 392 pikë në Gjmnastikën Artistike për Femra dhe është

renditur e para, duke lënë pas Klubin "Omnisporti", Klubin "Fushë-Kosovës", Klubin "Ferizaj" etj. Ndërsa në Gjmnastikën Artistike për Meshkuj, Akademia e Gjmnastikës "Universiteti" ka arritur të tubojë 129 pikë, duke u renditur i pari. Në vendin e dytë është renditur Klubi i Gjmnastikës "Ferizaj" ndërsa në të tretin "Omnisporti".



## Ish-trajneri i Polonisë mund të emërohet trajner i Kosovës

PRISHTINË, 12 JANAR - Ish-trajneri i Polonisë, Jerzy Brzeczek, thuhet se është kandidati kryesor për ta marrë pozitën e trajnerit në Përfaqësuesen e Kosovës. Pas një periudhe në

kombëtaren e Polonisë, Brzeczek, rriti ndjeshëm kërkesat e tij financiare dhe nuk kishte klub që do t'i përmbushte pritshmëritë e trajnerit nga Truskololas. Sipas

"SportoweFakty WP", Brzeczek është kandidati kryesor për të marrë përsipër pozitën e trajnerit të Kosova. Ish-trajneri i Polonisë ka biseduar tashmë me FFK-në dhe ka paraqitur

konceptin dhe metodologjinë e tij të punës. Tani është në pritje të vendimit përfundimtar të autoriteteve të Federatës së Futbollit të Kosovës.



### SHKURT

#### Kosova, organizatore e ndeshjeve të dy grupeve të Kampionatit Evropian

Kosova do të jetë nikoqire e përballjeve të Grupit I, respektivisht E, në kuadër të Kampionatit Evropian për grupmoshën U19 femrat dhe U22 meshkujt. Sa i përket konkurrencës së femrave, Kosova organizon ndeshjet e Grupit I, ku bën pjesë së bashku me Turqinë, Estoninë dhe Hungarinë, teksa takimet luhen mes datave 7-11 prill 2022. Garojnë volejbolliste të lindura më 2004 ose më të reja. Në konkurrencën e meshkujve, Kosova organizon ndeshjet e Grupit E teksa, përveç 'Dardanëve', në këtë grup bëjnë pjesë edhe Holanda, Sllovakia dhe Azerbajxhani, me ndeshjet që luhen mes datave 19 dhe 23 maj. Garojnë volejbollistë të lindur më 2001 ose më të rinj. Të qenit nikoqire e këtyre dy evenimenteve jashtëzakonisht të rëndësishme për volejbollin evropian, për Kosovën është arritje në vete, marrë parasysh konkurrencën e madhe të shteteve për të fituar të drejtën e organizimit të këtyre garave.

#### Thompsoni përforcon KB Bashkimi

KB Bashkimi është përforcuar me basketbollistin amerikan Kendrick Thompson. 25-vjeçari do ta zëvendësojë amerikanin Avi Toomer, i cili është larguar nga skuadra, ndërsa së shpejti do të kemi edhe një përforcim tjetër në vend të qendrës Immanuel King, i cili për shkaqe familjare është kthyer në ShBA. "Thompson luan në pozitën 2 dhe është 191 cm i gjatë. Ai ka luajtur në kolegjin amerikan Northeastern State, me mesatare prej 16.07 pikëve për ndeshje, dhe së fundi në Gjeorgji me skuadrën Olimpi, ku ka pasur mesatare prej 14.63 pikëve për ndeshje", thuhet në njoftimin e skuadrës prizrenase. Thompsoni në rast të kompletimit të dokumentacionit me kohë, pritet të debutojë qysh në ndeshjen e nesërme kundër Pejës.

#### Roma rikthen interesimin e Xhakës

AS Roma thuhet se do ta ringjallë interesimin për mesfushorin shqiptar të Arsenalit, Granit Xhaka. 29-vjeçari ishte një objektiv kryesor për "Giallorossët" verën e kaluar, por ai përfundoi duke nënshkruar një kontratë të re me "Topçinjtë" në muajin gusht. Megjithatë, trajneri Jose Mourinho është ende i etur për Xhakën dhe dëshiron ta ribashkojë atë me Ainsley Maitland-Niles te Roma pas nënshkrimit të mbrojtësit të krahut si huazim nga Arsenal. Sipas mediumit italian "Gazzetta dello Sport", Roma po planifikon ta ringjallë interesin e tyre për mesfushorin e Arsenalit, Granit Xhaka. Por, transferimi i yllit nga Kosova do të jetë i vështirë, pasi ai është anëtar kryesor i formacionit të Mikel Artetas. Ndryshe, Xhaka në ditët e fundit ka rezultuar pozitiv me Covid-19 dhe është ende jashtë fushave derisa të marrë një test negativ.

## Ramiz Sadiku angazhon Sermaxhaj

PRISHTINË, 12 JANAR - Trajneri i mirënjohur Sami Sermaxhaj i është bashkuar klubit kryeqytetas, Ramiz Sadikut. Sermaxhaj është emëruar këshilltar profesional me

qëllimin për ta ndihmuar klubin për ndërtimin dhe zhvillimin e futbollistëve të rinj. Kështu ka bërë me dije faqja zyrtare e klubit prishtinas përmes një njoftimi. "Pjesë e KF

Ramiz Sadiku edhe trajneri i mirënjohur Sami Sermaxhaj, si këshilltar profesional, i cili do ta ndihmojë klubin për ndërtimin dhe zhvillimin e futbollistëve të rinj", thuhet në njoftimin zyrtar

të Ramiz Sadikut. Sermaxhaj kohë më parë drejtoi disa nga skuadrat elitare të futbollit në Kosovës, kurse për herë të fundit ishte pjesë e skuadrës së Drenicës së Skenderajt.



## Broja: Te Southamptoni ndihem si në shtëpi

SOUTHAMPTON, 12 JANAR - Armando Broja u bë protagonist me një tjetër supergol, i cili ishte i pesti në kampionat. Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, i intervistuar pas duelit, ka shprehur mirënjohjen edhe për shokun e tij, Romeu, që i shërbeu një asistim të bukur. "Mbrëmje e jashtëzakonshme këtu në një atmosferë të jashtëzakonshme, me publikun që na mbështeti dhe bëme një performancë fantastike nga fillimi në fund. Realisht nuk mund të kërkojmë më shumë. Për golin ka një meritë të jashtëzakonshme Romeu, që dha një pasim të përkrye. Sigurisht edhe unë kisha shumë punë për të bërë, por e falënderoj për pasimin e përkrye. Po shkon shumë mirë dhe po përpiqem të jem i fokusuar të puna ime. Jam i ri dhe po përpiqem të qëndroj me këmbë në tokë e të ndihmoj sa më shumë ekipin. Bëra një hap të madh duke ardhur nga kampionati holandez në Premierë Ligë, ndaj më është



dashur të mësoj shumë shpejt", ka thënë Broja. "Është ligë e mrekullueshme, më e mira në botë, por njëkohësisht shumë e vështirë. Megjithatë, djemtë me më shumë përvojë më kanë ndihmuar të përshtatem dhe unë po bëj pjesën time, ndaj jam i

lumtur që gjërat po shkojnë mirë. Pritja te Southamptoni ka qenë e mrekullueshme, pasi më ka bërë të ndihem si në shtëpi. Nuk mendoj shumë për gjëra jashtë futbollit. Fokusi im është ta ndihmoj ekipin me gola, asistime dhe sa më shumë pikë", ka deklaruar Broja.

## Gjokoviqi e pranon se ka shkelur masën e izolimit gjatë infektimit me Covid

MELBOURNE, 11 JANAR - Tenisti serb Novak Djokovic ka pranuar se ka gabuar kur ka vendosur të intervistohet nga një gazetar francez, ndonëse ka qenë i infektuar me koronavirus. Ai e ka pranuar, po ashtu, se një anëtar i stafit të tij ka bërë deklarata të rreme para qeverisë australiane rreth historisë së tij të udhëtimit. Në deklarata është thënë se ai nuk ka udhëtuar në 14 ditët e fundit askund para se të mbërrinte në Australi, mirëpo ai ka qenë edhe në Serbi para se të nisej nga Spanja. Megjithatë, Djokoviçi ka insistuar se raportimet e tjera rreth aktiviteteve të tij, pas infektimit me koronavirus, janë "dezinformata" dhe se "lëndojnë shumë" familjen e tij. Djokoviçi i ka bërë këto deklarata më 12 janar në "Instagram" teksa ka adresuar situatën në të cilën gjendet para se ta mbrojë titullin e kampionit në turneun e tenisit Australian Open, ndonëse i pavaksinuar. Tenisti 34-



vjeçar ka hyrë në Australi javën e kaluar me një dokument që tregonte se ai është infektuar me koronavirus më 16 dhjetor. Një ditë më vonë ai është parë pa maskë në një ngjarje të organizuar në Beograd për tenistët e rinj. Në postimin e tij në "Instagram", Djokoviçi nuk ka përmendur ceremoninë në Beograd, mirëpo ka thënë se e ka kuptuar më 17 dhjetor se është i infektuar, pasi ka marrë pjesë në ceremoni. Djokoviçi ka thënë se më 18 dhjetor ka anuluar të gjitha planet, mirëpo ka

vendosur të japë intervistë për gazetën franceze "L'Equipe" dhe të bëjë disa fotografi. "E kam parë si obligim që të vazhdoj intervistën, sepse nuk kam dashur t'i dështoj planet e gazetarit, mirëpo kam mbajtur distancën fizike dhe kam pasur maskë, edhe pse më janë bërë fotografi".

Më 10 janar një gjyqtar australian ka fuqizuar vizën e tenisit, ndonëse ajo i ishte refuzuar javën e kaluar, pasi tenisti i pavaksinuar kundër koronavirusit është thënë se ka shkelur rregulloret e Australisë për luftim të pandemisë. Ai ka siguruar një dokument mjekësor nga organizata për tenis në Australi, që i mundësonte shmangien e kufizimeve për të hyrë në këtë shtet, pasi ka deklaruar se është infektuar me koronavirus muajin e kaluar. Ministri australian për Migrim, Alex Hawke, ka paralajmëruar se është duke konsideruar mundësinë e ushtrimit të fuqisë ekzekutive për ta dëbuar Djokoviçin.

### SHKURT

#### Digne transferohet tek Aston Villa

Lucas Digne do t'i bashkohet Aston Villas pasi Villains ra dakord për një tarifë transferimi prej 25 milionë funtash me Evertonin. Disa skuadra kanë treguar interesim për nënshkrimin e Digne gjatë merkatos së janarit, duke përfshirë Chelsea, Newcastle Unitedin dhe Interin, por francezi do t'i bashkohet trajnerit Gerrard pasi t'u nënshtror testeve mjekësore në Birmingham të mërkurën. Transferimi i Dignes vjen vetëm disa ditë pas ardhjes së Philippe Coutinhos, i cili i është bashkuar klubit anglez në formë huazimi deri në fund të sezonit, me një opsion blerjeje të përfshirë për 33.3 milionë paund.

#### Comani vazhdon kontratën me Bayernin

Kingsley Coman ka nënshkruar kontratë të re me Bayern Munchenin deri më 2027. Vazhdimisht raportohej për një largim të mundshëm të Kingsley Coman nga "Allianz Arena", por sulmuesi do të qëndrojë deri në vitin 2027. Klubi ka konfirmuar se francezi ka rinovuar kontratën dhe vazhdon të jetë pjesë e rëndësishme e ekipit. 25-vjeçari është pjesë e Bayernit që nga viti 2017. Deri më tani ai ka bërë 157 paraqitje, ka shënuar 37 gola dhe ka fituar 17 trofe.

#### Atletico i gatshëm ta shesë Felixin te City

Klubi spanjoll Atletico Madrid është i gatshëm të pranojë një ofertë nga Manchester City për yllin portugez Joao Felix. Portugezi është një lojtar që i intereson klubit anglez, veçanërisht pas humbjes së Ferran Torres këtë muaj pasi u transferua te Barcelona. Sipas mediumit "O Jogo", City po përgatit një ofertë prej 70 milionë eurosh për yllin portugez. Ky medium shton se klubi nga Wanda Metropolitan është i gatshëm të bëjë biznes. Atletico do të ishte gati ta shesë Felixin dhe më pas të investojë paratë e mbledhura për të nënshkruar me Darwin Nunez nga Benfica këtë verë. Sulmuesi uruguaiian, dikur i Almerias, aktualisht është golashënuesi më i mirë në Portugali, me 13 gola të shënuar në 14 ndeshje. Në anën tjetër, Felix u ble për mbi 100 milionë euro për ta zëvendësuar Antoine Griezmann, por ka dështuar t'i tregojë vlerat.

#### Memphisi mposht Golden State, hedh kandidaturën për titull

Fitorja e 10-të radhazi në NBA për Memphisin, që mposhti me rezultat 116-108 Golden Staten, duke u konfirmuar si ekipi më i mirë aktualisht në kampionat. Morant po bëhet gjithnjë e më shumë lider i këtij ekipi e protagonist këtë sezon, duke realizuar edhe 29 pikë. Në kahun tjetër Curry realizoi një "triple double" (27 pikë, 10 rebounde, 10 asistime), por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Gjithsesi, suksesi i sotëm e bën Memphisin kandidat serioz për titullin këtë sezon në NBA. Në Lindje, ekipi i Chicagos nis shkëputjen, pas fitores 133-87 ndaj Detroitit. Një fitore kolektive, pasi 8 lojtarë të Bullsit realizuan mbi 10 pikë. Në sekondat e fundit fitojnë edhe clippersat, që mundën 87-85 Denverin (Coffey 18 pikë), ndërsa Phoenixi fitoi me rezultat 99-95 ndaj Torontos (Crowder 19 pikë), duke marrë kreun e renditjes në Perëndim. Rezultatet: Washington-Oklahoma (122-118), Toronto-Phoenix (95-99), Chicago-Detroit (133-87), Memphis-Golden State (116-108), New Orleans-Minnesota (128-125), Clippers-Denver (87-85).

## Nëse shkon Mbappe, Ronaldo vjen në PSG

Paris Saint Germaini po planifikon një lëvizje për ta sjellë superyllin e Manchester Unitedit, Cristiano Ronaldo në Francë për ta zëvendësuar Kylian Mbappen në largim. PSG-ja thuhet se ishte e interesuar për një lëvizje për

kapitenin e Portugalisë verën e kaluar kur Mbappe dukej se do t'i bashkohej Real Madridit. Kjo lëvizje mund të ndodhë përfundimisht me skadimin e kontratës së Mbappes në kryeqytetin francez dhe Ronaldo që ka rënë në

mosmarrëveshje me trajnerin e përkohshëm të Unitedit, Ralf Rangnick. Nëse Ronaldo dëshiron të largohet nga "Old Trafford", më pak se 12 muaj pas kthimit në ish-klubin e tij, PSG do të ishte destinacioni i tij më i mundshëm pasi nuk

kishte luajtur kurrë më parë në ligën franceze. Ai, gjithashtu, do të bashkohej me Lionel Messin për herë të parë ndonjëherë në një kombinim të dy prej më të mëdhenjve të të gjitha kohëve një mundësi reale. Gjithçka varet, megjithatë, nga largimi i

Mbappes nga parisienët në fund të sezonit me zemrën e tij të vendosur te Real Madridi. Ai do të shprejë që një lëvizje në kryeqytetin spanjoll do ta bëjë atë të arrijë të njëjtat lartësi siç arriti Ronaldo gjatë kohës së tij në "Los Blancos".



Shqipta Humanitare Bëmëse e Kosovës "Nëna Teresa"  
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"  
Humanitarna Društvo "Nëna Teresa" Kosovo "Mother Teresa"  
38400 Prishtinë, Rr. Agim Ramadani, p.n. Tel: 03031 38 542 864, Fax: 542 869,  
Web site: www.nanateresa.org e-mail: nanateresa@yaho.com

## CONTRACT NOTICE SERVICES

According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 13/01/2022

Procurement No	Training	001	2022	221
----------------	----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

### SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

#### I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

<b>Official name:</b> Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
<b>Postal address:</b> str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1		
Town: <i>Prishtina</i>	Postal code: 10000	Country: Kosovo
<b>Contact point(s):</b> Zef Shala		Telephone: 038-542-865
Email: zefshala@hotmail.com		Fax: 038-542-869
Internet address (if applicable):		www.mathertesasociety

### SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

#### II.1) DESCRIPTION

<b>II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:</b> Training on Entrepreneurship and self-employment for 560 participants -New beneficiaries (Returnees and people at risk of illegal emigration)	
<b>II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance</b> (Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)	
	<input checked="" type="checkbox"/> Services
<b>II.1.5) Short description of the object of the contract</b> Training on Entrepreneurship and self-employment for 560 participants -New beneficiaries (Returnees and people at risk of illegal emigration)	
<b>II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)</b> <b>93.000.000.-8</b>	
<b>II.1.7) Variants are accepted</b>	No <input checked="" type="checkbox"/>
<b>II.1.8) Division into lots</b>	NO <input checked="" type="checkbox"/>
<b>II.1.11) Estimated contract value: 115,000.00</b>	

#### II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT

#### II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION

Duration in months 7 month (from the contract signature)
or
Starting 01/03/2022
Completion 31/05/2022

### SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION

#### III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT

<b>III.1.1) Performance security required</b>	No <input checked="" type="checkbox"/>
<b>III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded (if applicable)</b>	
<b>III.1.3) Other particular conditions to which performance of the contract is subject</b>	No <input checked="" type="checkbox"/>

#### III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION

<b>III.2.1) Eligibility Requirements:</b> 1. Certificate of Business Registration 2. Fiscal Number Registration 3. VAT-Certifikat if applicable <i>Documentary evidence required</i> <b>Copy of documentary</b>
<b>III.2.2) Professional Suitability:</b> 1. Business Registration Certificate 2. List of proposed experts and administrative staff and their CV-s 3. References of previous experience in similar projects <i>Documentary evidence required:</i> <b>Copy of prove documents</b>
<b>III.2.3) Economic and financial capacity</b> 1. Tax Verification from Tax Administration of Kosovo only for Winner 2. Court Certificate only for Winner 3. Company profile <i>Documentary evidence required:</i> <b>Copy of documentary</b>
<b>III.2.4) Technical and professional capacity</b> 1. Business License Certificate <i>Documentary evidence required:</i> <b>Copy of prove documents</b>

#### III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS

<b>III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession</b>	No <input checked="" type="checkbox"/>
--	--

**III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the service** Yes

### SECTION IV: PROCEDURE

#### IV.1) TYPE OF PROCEDURE

<b>IV.1.1) Type of Procedure</b>
<input checked="" type="checkbox"/> Open

#### IV.2) AWARD CRITERIA

<b>LOWEST PRICE</b>
---------------------

#### IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

<b>IV.3.1) Previous publications concerning the same contract</b>	No <input checked="" type="checkbox"/>
<b>IV.3.2) Conditions for obtaining tender dossier</b> Time limit for receipt of requests for tender dossier: date 25/01/2022	
<b>Payable documents</b>	No <input checked="" type="checkbox"/>
<b>IV.3.3) Time limit for receipt of tenders Additional information</b> date 01/02/2022 time 14:00 place Prishtina	
<b>IV.3.4) Time limits is shortened for submission of tenders</b>	<input checked="" type="checkbox"/> no
<b>IV.3.5) Is tender security needed:</b>	No <input checked="" type="checkbox"/>
<b>IV.3.6) Tender validity period: date: 15/02/2022 days 30 or months 1</b>	
<b>IV.3.7) Tender opening meeting:</b> Date 15/02/2022 time 14:30 place Prishtina	

### SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

#### V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract notice.

#### V.2) ADDITIONAL INFORMATION

Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in Albanian, Serbian or English.

Standard Form "Contract Notice"

3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollli 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 12.01.2022 bënë shpallje publike:

### NJOFTIM PËR DHËNE KONTRATËS: T-21-010

Kemi pranuar një ofertë nga Shala shpk.

Me kontratë shpërblehet Shala shpk., me ofertë 472.00 € me TVSH.

Kontrata është paraparë të nënshkruhet me datën 23.01.2022 ora 10:00

#### AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

<b>Emri zyrtarë:</b> Trepça sh.a.		
<b>Adresa postare:</b> Parku inustrial		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Kosovë
<b>Kontakti:</b> Burim HAJDINI		Telefoni: +383 (0) 28 538 050
Email: sales@trepcacorporation.com		Faksi: +383 (0) 28 539 202
www.trepcacorporation.com		

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 te Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollli 119 date 11.01.2021.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

